



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:155102

Datë: 12.11.2020

Numri i dokumentit: 01266850

P.nr.944/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i çështjes Avni Sylja, me Bashkëpunorën Profesionale Bleta Gashi Rrusta, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B.nga P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.6651/2018 të datës 12.03.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 06.11.2020, në prezencën e përfaqësueses së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurori i Shtetit Bekim Kodraliu dhe të akuzuarit F.B., me datë 09.11.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.11.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.B., i biri i H. dhe nënës N. e gjinisë K., I lindur me datë ... nga P., me vendbanim në Lagjen, i pa martuar, student, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 12.08.2018 rreth orës 22:30 në Prishtinë, në parkun e Gërmisë I pandehuri F.B.pa autorizim ka poseduar substancë narkotike me peshë 0.8 gram, e cila I është gjetur gjatë një kontrolli nga ana e policisë dhe për të cilën pas ekzaminimit është vërtetuar se është substance narkotike e llojit Marihuanë.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave të cituara më lartë dhe neneve 7, 17, 21, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin **F.B.**me dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë gjobën, gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, do të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që për një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 € (njëzetë Euro) gjobë.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ (njëzet Euro) dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë euro) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 275 par 3 të KPRK-së, substance narkotike e llojit Marihuanë me peshë 0.8 gram konfiskohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.6651/2018 të datës 12.03.2019, ka akuzuar F.B.për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 16.11.2020 ku pas leximit të aktakuzës, Prokurori i Shtetit Bekim Kodraliu ka bërë rikualifikimin ligjor të veprës penale pasi që në dispozitivin e aktakuzës është përcaktuar pesha e narkotikut prej 0.8 gram, ashtu që tani e tutje duhet të jetë vepra penale Posedimi i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, pjesa tjetër ka theksuar mbetet e pa ndryshuar dhe pasi që i akuzuari F.B.është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, i njëjti është deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale për aktakuzën që i vihet në barrë nga Prokuroria e Shtetit, duke shtuar se ndien keqardhje para gjykatës për çka akuzohet, por që ka qenë në moshë të re dhe në një festival që ishte organizuar në këtë vit “Sani Hill” është e vërtetë se ka përdorur një cigare substancë narkotike për çka është penduar thellësisht dhe i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale tani është student i fakultetit të shkencave kompjuterike dhe kërkon nga gjykata që me rastin e dënimit të shqipton një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse i pandehuri në këtë seancë fillestare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, gjykatës i propozon që këtë pranim ta aprovoi pasi që konsideron se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në nenin 248 të KPRK-së, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, duke i kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat që i përmban aktakuza, i propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Pasi që gjykata konstatoi që i akuzuari e pranoi në tërësi veprën penale me të cilën është ngarkuar, që i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, që pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjykata nuk do të administrojë provat e bashkëngjitura në aktakuzë por kalojë në matjen e dënimit.

Gjatë matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata i vlerësoi të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, andaj gjykata si

rrethanë lehtësuese mori faktin e pranimit të fajësisë, faktin se për here të parë ka ra ndeshë me ligjin, i njëjti është penduar thellë dhe ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, andaj të akuzuarit konform nenit 46 të KPRK-së, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro), të cilin obligohet ti paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e tij si dhe do të ndikojë tek të tjerët që mos të kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i shqiptimit të dënimit me gjobë konform nenit 46 të KPRK dhe qëllimi i shqiptimit të dënimeve të përgjithshme i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 e lidhur me nenin 453 par. 4 të KPPK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 39 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike e llojit Marihuanë me peshë prej 0.8 gram u mor në bazë të nenit 275 par 3 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.944/19, dt. 12.11.2020

Bashkëpunëtore Profesionale
Bleta Gashi Rrusta

G j y q t a r i
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.